BALKAN MONITORING PUBLIC FINANCES
www.wings-of-hope.ba

BIRN
BALKAN INVESTIGATIVE REPORTING NETWORK

This project is funded by the European Union

## Monitorimi Ballkanik i Financave Publike SHPALL:

# THIRRJE PUBLIKE PËR ORGANIZATA TË SHOQËRISË CIVILE/ ORGANIZATA JO-QEVERITARE

**PËR DËRGIM TË PROJEKT PROPOZIMEVE NË KUADËR TË PROGRAMIT TË BASHKIMIT EUROPIAN PËR PËRKRAHJE TË SHOQËRISË CIVILE DHE MEDIAVE 2014-2015:** Përkrahje për koalicionet tematike regjionale të Organizatave të Shoqërisë Civile – "OJQ-të si partnerë të barabartë në monitorimin e financave publike"

**Monitorimi Ballkanik i Financave Publike** fton të gjitha organizatat e shoqërisë civile (OSHC)/organizatat jo-qeveritare (OJQ) nga Ballkani Perëndimor (Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi) që të dorëzojnë projekt propozime që janë në pajtim me objektivat zhvillimore të projektit Monitorimi Ballkanik i Financave Publike, dhe që adresojnë prioritetet në zhvillim, më poshtë:

- Fuqizimi i OSHC-ve për të rritur njohuritë e tyre në fushën e financave publike, monitorimin financave publike, ofrimin e propozimeve të politikave dhe pjesëmarrjen në politikëbërje, ngritjen e vetëdijes publike, lehtësimin e dialogut me akterët politikë dhe akterët tjerë me rëndësi, komunikimin dhe avokimin për llogaridhënie dhe transparencë në fushën e financave publike;
- Përkrahja e mediave për të komunikuar dhe informuar publikun në çështjet apo proceset e politikëbërjes në lidhje me financat publike;
- Inkurajimi i ekspertëve për të bërë hulumtime dhe studime themelore në tema specifike që lidhen me financat publike;
- Krijimi i platformave të bashkëpunimit apo përkrahja e formimit të lidhjeve mes palëve të ndryshme të interesit për krijimin e politikave transparente dhe llogaridhënëse dhe të proceseve vendimmarrëse në fushat e financave publike.

Kjo thirrje për propozime ekskluzivisht fokusohet në katër tema të përgjithshme të financave publike siç janë borxhi publik, partneriteti publiko-privat, drejtësia tatimore dhe infrastruktura publike. Fondet do të ndahen për ato organizata të shoqërisë civile projektet e të cilave kontribuojnë në zgjidhjen e njërës apo më shumë prioriteteve dhe i plotësojnë kriteret e kualitetit dhe kushtet tjera.

Projekte të pranueshme për këtë thirrje publike janë ato projekte buxhetet e të cilave janë ndërmjet 4,000 dhe 8.000 Euro. Projekti BMPF rezervon të drejtën që të mos japë të gjitha fondet në dispozicion në rast se projekt propozimet nuk i plotësojnë kriteret e dhëna. Fondet në dispozicion për këtë thirrje janë 45.600 euro për çdo vend. Projekti BMPF ka të drejtë që mos të shpërndaje të gjitha fondet në dispozicion në

This project has been prepared with the financial assistance of the European Union. The content of the document is the sole responsibility of the project partners and can under no circumstances be regarded as reflecting the position of the European Union.

rast se projekt propozimet nuk i plotësojnë kriteret e mësipërme. Fondet në dizpocion për këtë thirrje janë 45,600 Euro për secilin vend.

Kohëzgjatja e projekteve mund të jetë ndërmjet 4 dhe 6 muaj, dhe ato duhet të zbatohen në periudhën ndërmjet 01/12/2018 dhe 31/05/2019. Aktivitetet që ndodhin para kësaj date nuk mund të financohen.

Pjesëmarrja në këtë thirrje është e hapur për të gjithë në baza të barabarta, për OSHC dhe OJQ (shoqata apo fondacione) formalisht të regjistruara në Ballkanin Perëndimor (Bosnja dhe Hercegovina, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi) dhe në pajtim me rregulloret e vlefshme ligjore.

**Të gjitha organizatat e shoqërisë civile mund të gjejnë informata të detajuara mbi kushtet për aplikim dhe kriteret për financim të projekteve në Udhëzuesin për aplikantët, që është pjesë përbërëse e kësaj thirrje publike.**

Informata përkatëse si dhe versioni elektronik i tërë pakos së aplikacionit mund të gjendet në: http://wings-of-hope.ba/balkan-monitoring-public-finance/public-call-for-csos/ngos-in-the-field-of-public-finances. Aplikantët duhet të dërgojnë aplikimet e tyre në gjuhën lokale.

Nëse kërkohet ndonjë informatë apo sqarim shtesë, kandidatët potencial mund të dërgojnë kërkesën e tyre me reference tek Thirrje Publike për Aplikantë në email adresën: diellza.salihu@birn.eu.com Pyetjet mund të dërgohen deri me **19 tetor 2018,** dhe përgjigjet do të ofrohen me shkrim brenda 5 ditëve të punës nga dita e pranimit të kërkesës. Për qëllime transparente, përgjigjet do të publikohen po ashtu në faqen e internetit të projektit.

Aplikimet e kompletuara, me të gjitha dokumentet obliguese, duhet të dërgohen përmes emailit në: diellza.salihu@birn.eu.com Në titull të emailit, duhet të shkruhet: Projekt propozim në kuadër të thirrjes “BMPF“.

Secili aplikant që ka dorëzuar një projekt dhe që është pranuar në kohë do të marrë një përgjigjen adekuate. Afati i fundit për të dorëzuar aplikime është **e enjte, 1 nëntor në ora 12:00 (mesditë).** Aplikacionet e dërguara me mjete tjera (p.sh. me faks apo postë) apo të dërguara në adresa tjera **nuk do të merren në konsideratë**.

Të gjithë aplikantët, pavarësisht se a do të aprovohet apo refuzohet projekt propozimi i tyre, do të njoftohet me shkrim për vendimin mbi projektin e tyre 24 ditë pas mbylljes së thirrjes publike. Rezultatet

do të publikohen në faqen e internetit të projektit: http://wings-of-hope.ba/balkan-monitoring-public-finance/public-call-for-csos/ngos-in-the-field-of-public-finances.